

**Trajnimi i imamëve dhe i mësuesve të edukatës islame në Zvicër  
mes nevojës reale vendore dhe frikës së importuar**

Mr. Rehan Neziri  
Imam & Mësues i edukatës fetare islame në Kreuzlingen të Zvicrës

Prishtinë, 21.10.2011

**Abstrakt:** Vendosja e muslimanëve në Zvicër tërheq pas vete edhe hapjen e xhamive dhe ardhjen e imamëve. Imamët ballafaqohen me sfida reale gjuhësore, kulturore e profesionale. Vërehet nevoja e qartë si të muslimanët ashtu edhe të jo-muslimanët e Zvicrës për krijimin e institucioneve për edukimin dhe/ose trajnimin e imamëve këtu në tokën dhe realitetin zviceran. Për momentin, si masa të përkohshme, ofrohen kurse të ndryshme rreth Islamit, dialogut ndërfaqetor dhe kulturës zvicerane.

**Fjalët kyçe:** migracion, musliman, Zvicër, imam, mësues i edukatës fetare islame, përkujdesës shpirtëror, integrim, trajnim i imamëve...

Valët e para të migrimit të muslimanëve drejt Zvicrës kanë ndodhur me emigrantët e krahut të punës në vitet 1960 dhe 1970 për të vazhduar më vonë me migrimin azilkërkues të viteve 1980 dhe 1990 dhe për t'u zgjeruar me sjelljen e familjeve të punëtorëve nga viti 1990 e këndeje.

Hapja e xhamive dhe e qendrave islame, andaj edhe angazhimi i imamëve dhe i mësuesve fetarë, në Zvicër zë fill pikërisht në vitet 1990, kur këta mërgimtarë kishin sjellë me vete edhe familjet e tyre dhe kishin kuptuar se ata nuk po ktheheshin së shpejti përgjithmonë në vendlindje, porse do të qëndronin këtu edhe për një kohë të gjatë.

Për momentin në Zvicër janë aktive afro 200 xhami, faktore apo qendra islame të cilat kryesisht ndahen sipas gjuhës së predikimit dhe gjuhës së xhemit shumicë që kanë, në xhami: shqiptare, boshnjake, turke, arabe etj. dhe të cilat kanë të punësuar mbi 100 imamë dhe mësues të edukatës islame\*. Jo të gjitha xhamitë kanë punësuar imam të rregullt. Disa prej tyre kanë nga një imam që angazhohet në xhami vetëm për fundjavë, si angazhim plotësues krahas angazhimit të plotë në fabrikë a gjetiu. E disa xhami, për shkak të numrit të vogël të anëtarëve dhe të mjeteve të mangëta financiare, mjaftohen me nga një imam që e angazhojnë vetëm gjatë muajit të Ramazanit.

Është vërejtur se përgatitja arsimore, profesionale dhe gjuhësore e një pjese të këtyre imamëve dhe gjysmë-imamëve (njerëz që kryejnë funksionin e imamit edhe pse nuk kanë kryer ndonjë arsimim adekuat), edhe ashtu të paktë në numër sidomos në vitet e para të vendosjes së tyre në Zvicër, nuk ka qenë e lakmueshme as edhe për vetë besimtarët muslimanë, të cilët ose vetë ose përmes fëmijëve të tyre, janë ballafaquar me një realitet të ri, me një rreth kulturor e mendor tjetër nga ai që e kanë lënë në vendlindje. Ndër sfidat e para të këtyre imamëve ka qenë trajtimi i vendit pritës si vend jo-islam ku nuk duhet qëndruar gjatë në të dhe si vend ku gjithsesi do të ndodhë asimilimi apo tjetërsimi fetar, kulturor e kombëtar i brezave të ardhshëm të mërgimtarëve muslimanë. E gjithë kjo si pasojë e vazhdimit të koncepteve të vjetra të ndarjes së botës në islame dhe jo-islame dhe si pasojë e mungesës së aftësisë për të bërë

---

\* Mësimi fetar islam zhvillohet kryesisht nëpër mektebet (klasat) e xhamive ekzistuese si dhe në shkollat publike të 4 qyteteve të ndryshme të Zvicrës (në Wil [SG], Luzern [LU], Obersiggenthal [AG] dhe tek unë në Kreuzlingen [TG]). Më gjerësisht për këtë shih: Alimi, Bekim & Zuzo, Zijad (2011), *Islamischer Religionsunterricht an Schweizer Schulen*, CAS Religiöse Begleitung im interkulturellen Kontext, ZHAW für Angewandte Wissenschaft und Islamische Gemeinschaft Wil. Po ashtu edhe nën: [www.uais.ch/new1/images/files/Islamischer\\_Unterricht\\_in\\_Wil.pdf](http://www.uais.ch/new1/images/files/Islamischer_Unterricht_in_Wil.pdf) (shikuar më 11 tetor 2011).

ndarjen midis *tekstit* islam dhe *kontekstit* të ndryshëm kohor e hapësinor, siç do të kishte thënë Tariq Ramadan. Sfida e dytë e madhe është vërejtur në mosnjohjen e një gjuhe të huaj lokale për të komunikuar së paku me një gjuhë bashkuese me vetë muslimanët e nacionaliteteve të ndryshme në xhami si dhe me të rinjtë, të cilët më vonë më mirë do ta kuptojnë një gjuhë të vendit pritës sesa gjuhën standarde të imamit. E njëjta ka munguar edhe në komunikimin me autoritetet vendore si dhe me përfaqësuesit e feve të ndryshme të atij lokaliteti ku ka vepruar imami. Sfida e tretë me radhë e imamëve është shprehur në mosnjohjen e historisë, kulturës, strukturës sociale e sistemit politik të vendit pritës, gjë që e ka shtuar akoma më shumë arsyen për të mos komunikuar me vendorët dhe për t'u izoluar gjithnjë e më shumë brenda mureve të xhamisë apo brenda komunitetit të njëjtë fetar e nacional.

Këtyre sfidave reale në terren, sidomos pas 11 shtatorit 2001, fillon t'i bashkëngjitet edhe importimi i frikës që krijohet në arenën ndërkombëtare kundrejt Islamit dhe muslimanëve. Kjo frikë - që me të drejtë e quajmë të importuar, ngase muslimanët e Zvicrës nuk kanë planifikuar e lëre më të kenë ndërmarrë ndonjë aksion ekstremist kundrejt shtetit apo popullit zviceran që do t'u përngjante atyre që janë kryer në përmasa ndërkombëtare - përmes diskursit të ashpër politik e medial zviceran arrin të transformohet në fobi të vërtetë ndaj Islamit dhe muslimanëve, të cilët fillojnë të shikohen nga vendasit si kërcënim dhe rrezik potencial për qetësinë e tyre të gjithëmbarshme. Vlen të theksohet se derisa nuk kishin ndodhur ngjarjet ekstremiste në arenën ndërkombëtare (sulmet në Qendrën Botërore Tregtare të Nju Jorkut, sulmet në Madrid e Londër si dhe reaksionet e dhunshme ndaj publikimit të karikaturave të Muhamedit s. a. v. s. në Danimarkë...) që lidheshin me Islamin dhe muslimanët, mërgimtarët me përkatësi muslimane nuk karakterizoheshin nga shoqëria pritëse si muslimanë apo pjesëtarë të Islamit, porse në bazë të përkatësisë së prejardhjes së tyre nacionale. Kështu, frika e pavend ndaj Islamit dhe muslimanëve u përdor nga elemente politike të mbështetura nga medie të caktuara sa herë që e shihnin të nevojshme këtë. Kjo u shpreh në referendumin e vitit 2004 kundër lehtësimit të procedurës për marrjen e nënshtetësisë përmes lindjes, në referendumin e 2009 kundër ndërtimit të minareve etj.<sup>1</sup>

Një pjesë e kësaj fobie u drejtua kah disa imamë dhe gjysmë-imamë, të cilët edhe ashtu i kishin mangësitë e përmendura më lart: mosnjohja e kontekstit kohor dhe hapësinor, mosnjohja e gjuhës dhe e realitetit të ri zviceran. Nisi të diskutohej haptas prania e "predikuesve të urrejtjes" nëpër xhamitë e Zvicrës dhe "indoktrinimi" i fëmijëve muslimanë nga mësues të tillë fetarë. Këto dhe probleme të ngjashme lidhur me imamët dhe mësuesit e edukatës islame u morën seriozisht si nga mediet ashtu edhe nga partitë politike dhe nga qeveria zvicerane.

Në vazhdimësi të kësaj situatë të krijuar, qeveria zvicerane lëshoi një urdhëresë (*Verordnung*) lidhur me integrimin e të huajve në shoqërinë zvicerane, ku në kapitullin 2, neni 7 rregullohet çështja e lejes së qëndrimit të të huajve që kryejnë aktivitete përkujdesjeje e edukimi, siç janë kuadri fetar dhe mësuesit e gjuhëve amtare të të huajve, me ç'rast marrja ose vazhdimi i lejes për qëndrim në Zvicër i këtyre personave që luajnë rol ndërlidhës mes një komuniteti dhe shtetit (*Brückenpersonen*) kushtëzohet ndër të tjera edhe me mësimin e një gjuhe vendase në nivelin B1 sipas Kornizës së Referencës së Përbashkët Evropiane për Gjuhë pranë Këshillit Evropian dhe me njohjen

---

<sup>1</sup> Ettinger, Patrik & Imhof, Kurt (2009), *Ethnisierung des Politischen und Problematisierung religiöser Differenz (Schlussbericht)*, Bern, NFP 58 „Religionsgemeinschaften, Staat und Gesellschaft“. Po ashtu edhe nën linkun (shikuar më 11 tetor 2011): [www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58\\_Schlussbericht\\_Imhof.pdf](http://www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58_Schlussbericht_Imhof.pdf).

e sistemit të vlerave juridike të Zvicrës. Për këtë nevojitet nënshkrimi i një kontrate integrimi që ofrohet nga autoritetet kantonale.<sup>2</sup>

Për të hulumtuar gjendjen në terren, e sidomos nevojën e arsimimit dhe edukimit të imamëve e mësuesve të edukatës islame nëpër institucionet arsimore të Zvicrës, nga fakti se të gjithë imamët e angazhuar në Zvicër pa përjashtim janë arsimuar e trajnuar jashtë vendit, Programi Kërkimor Nacional “Bashkësitë fetare, shteti dhe shoqëria” (*Nationales Forschungsprogramm “Religionsgemeinschaften, Staat und Gesellschaft”, NFP 58*), mbështetur nga Fondi Kombëtar Zviceran për Avancimin e Kërkimit Shkencor (*Schweizerischer Nationalfonds zur Förderung der Wissenschaftlichen Forschung*), më 21 korrik 2009, publikoi raportin final të titulluar **“Imam-Ausbildung und islamische Religionspädagogik in der Schweiz”** (Trajnimi i imamëve dhe pedagogjia fetare islame në Zvicër), ku mbi 100 të intervistuar muslimanë (imamë, kryetarë xhamish a organizatash të ndryshme islame) dhe mbi 40 opinione të institucioneve zvicerane (parti politike, ente shtetërore për arsim dhe integrim, universitete e shkolla të larta pedagogjike si dhe ekspertë të së drejtës) shprehen qartë për nevojën e trajnimit të imamëve dhe mësuesve fetarë brenda hapësirës apo kontekstit zviceran, qoftë përmes një shkollimi të mirëfilltë akademik qoftë përmes kurseve të ndryshme trajnuese ose përmes të dyjave.<sup>3</sup>

Më 7 shtator 2009 deputeti nga Gjeneva i partisë FDP, Hiltbold Hugues, shtron një interpelancë në parlamentin federal lidhur me rezultatet e kërkimit të mësipërm dhe kërkon sqarim nga parlamenti se çfarë hapa të mëtejme do të merren në këtë drejtim, nëse do të mund të realizohet dhe në çfarë forme një kurs trajnimi për imamët në Zvicër. Më 28.10.2009 parlamenti federal i përgjigjet me shkrim deputetit në fjalë se ata e kanë marrë seriozisht projektin e *NFP 58* si dhe rezultatet e tij rreth kësaj çështjeje dhe se ekziston pajtueshmëria se arsimimi i autoriteteve fetare nuk është punë e shtetit, porse para së gjithash bie në kompetencat e kantoneve dhe shkollave të larta e universiteteve. Lidhur me këtë, as edhe përpilimi i një raporti për modalitetet e kurseve të këtilla trajnuese nuk është çështje e parlamentit, porse para së gjithash e Konferencës së Universiteteve të Zvicrës (*Schweizerische Universitätskonferenz – SUK*), si një organ i përbashkët i federatës dhe i kantoneve për bashkëpunimin politik-universitar.<sup>4</sup>

Këtë detyrë nuk e merr përsipër as Konferenca e Universiteteve të Zvicrës, me arsyen se ajo nuk mund të ofrojë shkollim e trajnim për një predikues fetar të një bashkësie fetare e cila nuk është njohur zyrtarisht dhe juridikisht nga ana e shtetit, po as edhe Konferenca e Rektorëve të Universiteteve të Zvicrës, me arsyetimin se nuk kanë kuadër të përshtatshëm për lëndët fetare islame.<sup>5</sup>

---

<sup>2</sup> Për më tepër shih: Der Schweizerische Bundesrat, *Verordnung über die Integration von Ausländerinnen und Ausländern (VIntA)*, 24 tetor 2007. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: [www.admin.ch/ch/d/sr/1/142.205.de.pdf](http://www.admin.ch/ch/d/sr/1/142.205.de.pdf).

<sup>3</sup> Për më tepër, shih: Prof. Dr. Rudolph, Ulrich dhe të tjerë (2009): *Imam-Ausbildung und islamische Religionspädagogik in der Schweiz? (Schlussbericht)*, Bern, NFP 58 „Religionsgemeinschaften, Staat und Gesellschaft“. Po ashtu edhe nën linkun në vijim (shikuar më 11 tetor 2011): [www.nfp58.ch/files/downloads/Schlussbericht\\_Rudolph\\_de.pdf](http://www.nfp58.ch/files/downloads/Schlussbericht_Rudolph_de.pdf).

<sup>4</sup> Shih më gjerësisht: „Ausbildung von Imamen in der Schweiz. Wie geht es weiter? (Interpellation)“. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: [www.parlament.ch/D/Suche/Seiten/geschaefte.aspx?gesch\\_id=20093743](http://www.parlament.ch/D/Suche/Seiten/geschaefte.aspx?gesch_id=20093743)

<sup>5</sup> Mäder, Lukas: “Wer ist für eine Imam-Ausbildung zuständig?”, e përditshmjja zvicerane “20 Minuten”. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: [www.20min.ch/news/schweiz/story/16402185](http://www.20min.ch/news/schweiz/story/16402185).

Sot çështja e arsimimit të imamëve dhe e mësuesve fetarë muslimanë nëpër institucionet akademike të Zvicrës është akoma temë e hapur dhe e pazgjidhur.\*

Për momentin, kurse trajnuese për imamë, mësues të edukatës fetare islame si dhe për të interesuar të tjerë në Zvicër ofrohen nga institucionet vijuese:

1. **Kursi i IPDN-së**<sup>6</sup> (Instituti për Pedagogji dhe Didaktikë Ndërfetare) në Köln të Gjermanisë i cili që nga viti 2001 ofron një kurs për pedagogjinë islame për personat që duan të angazhohen si mësues fetarë islamë.
2. **Instituti Islamologjik në Vjenë**<sup>7</sup>. Ky institut privat që nga viti 2007 organizon kurse në regjionin e Cyrihut, më saktë në Regensburg, të cilat janë të hapura si për muslimanët ashtu edhe për jo-muslimanët. Ky kurs zhvillohet në katër semestra dhe udhëhiqet nga Mr. Amir M. A. Zaidan. Deri më tani kanë mbaruar tri gjenerata, ku kanë marrë pjesë mbi 450 nxënës/pjesëmarrës.
3. **Certifikata “Islami, muslimanët dhe shoqëria civile” pranë Universitetit të Freiburgut**.<sup>8</sup> Qendra për kualifikim të mëtejshëm pranë Universitetit të Freiburgut në vitin 2010 ofron një kurs të këtillë për muslimanët dhe jo-muslimanët e interesuar, që për qëllim kishte njoftimin më për së afërmi me realitetet sociale, fetare e kulturore në Zvicër. Meqë nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të interesuarish për këtë kurs, ai nuk ka mund të realizohet. Ky kurs përmbante 5 module të detyrueshme, një zgjedhor dhe punimin përmbyllës.

---

\* Sipas disa të dhënave të sigurta por jo zyrtare, qysh në vitin 2005 pranë Universitetit të Lucernit (Luzern) është krijuar një komision që është marrë me çështjen e edukimit dhe trajnimit të imamëve. Ky komision fillon punimet e tij nën përkujdesjen e vetë rektorit të Universitetit të Lucernit, i cili pas një kohe, për shkaqe personale, e ndërpret këtë angazhim, me çka bie edhe tërë projekti i komisionit. Dy vite më vonë, më 2007, Ministria e Drejtësisë dhe e Policisë (*Eidgenössisches Justiz- und Polizeidepartement*), me në krye ministrin e saj të asokohshëm z. Christoph Blocher, fton afro 50 përfaqësues të komunitetit musliman në Zvicër, ku ndër të tjera propozohet edhe krijimi i një forumi me emrin “Islam und Sicherheit” (Islami dhe Siguria), gjë të cilën përfaqësuesit muslimanë e refuzojnë si për shkak të emrit ashtu edhe për shkak të qëllimit të gabuar të tij. Më 2008 në krye të këtij dikasteri vjen zonja Eveline Widmer-Schlumpf, e cila sidomos pas referendumit të vitit 2009, me ç’rast ndalohet ndërtimi i mëtejshëm i minareve, e rinis iniciativën e ministrit paraprak, por kësaj radhe me moton “Dialog me muslimanët”, ku me përfaqësues të organizatave islame diskutohet rreth bashkëjetesës së mëtejme dhe rrugëve të integritimit. Më 2010 në krye të kësaj ministrie vjen zonja Simonetta Sommaruga, e cila e vazhdon dialogun e nisur më herët me muslimanët në formë të një forumi, por me ndërprerje të gjata kohore. Nga ky forum, ndër të tjera, është krijuar edhe një komision që merret me çështjen e shkollimit të imamëve në Zvicër. Këtë komision për momentin e udhëheq kryetari i Konferencës së Rektorëve të Universiteteve të Zvicrës (*Rektorenkonferenz der Schweizer Universitäten*). Në këtë komision analizohet mundësia dhe natyra e edukimit apo trajnimit të imamëve në Zvicër, të jetë ky një edukim akademik/universitar apo i nivelit të një shkolle të lartë profesionale, të jetë ky një edukim vetëm për përgatitjen e imamëve apo edhe të mësuesve të edukatës islame nëpër shkollat publike si dhe të të ashtuquajturve “përkujdesës shpirtërorë” (*Seelsorger*), që kujdesen për të sëmurët dhe të burgosurit.

<sup>6</sup> Das Institut für Interreligiöse Pädagogik und Didaktik in Köln, [www.ipd-koeln.de](http://www.ipd-koeln.de)

<sup>7</sup> Islamologisches Institut in Wien, [www.islamologie.info](http://www.islamologie.info)

<sup>8</sup> Certificat de formation continue universitaire: *Islam, Musulmans et Société civile*. Më tepër nën linkun në vazhdim (shikuar më 11 tetor 2011): <http://unifr.ch/webnews/content/20/File/certificatIslam.pdf>

4. **“Shoqërimi fetar në kontekstin ndërkulturor”.**<sup>9</sup> Shkolla e Lartë e Cyrihut për Shkencat e Zbatuara (ZHAW) në qytetin Winterthur e organizon këtë kurs që nga shtatori i vitit 2009, ku në veçanti trajtohen çështjet e dialogut ndërfetar. Ky kurs përmban gjithsej pesë module (1. Hyrje në fetë qendrore në Zvicër, 2. Pluraliteti fetar në Zvicër, 3. Dialogu dhe komunikimi ndërfetar, 4. Raporti shoqëror me pluralitetin fetar në Zvicër, dhe 5. Punimi shoqëruar i një projekti ndërfetar ose ndërkulturor) dhe zgjat 9 muaj me nga një ditë e gjysmë për çdo muaj. Deri më tani kanë mbaruar dy gjenerata: në gjeneratën e parë kanë përfunduar 8 persona me përkatësi fetare krishtere dhe islame, kurse në gjeneratën e dytë kanë mbaruar 9 persona: 4 imamë, 4 përfaqësues të kishave të ndryshme krishtere dhe një përfaqësues nga bashkësia çifute. Gjenerata e tretë është lajmëruar të fillojë më 14 dhjetor 2011.
5. **Projekti i Universitetit të Bazelit.** Në vitin 2004 Akademia e Pedagogjisë Fetare (IRPA) në Vjenë i propozon Universitetit të Bazelit themelimin e një departamenti të teologjisë islame për imamë, mësues fetarë islamë dhe për të tjerë të interesuar. Ky projekt akoma qëndron pezull, për shkak se deri më tani nuk është arritur konsensus lidhur me çështjen e ndarjes së vendimmarrjes në mesin e donatorëve.<sup>10</sup>

---

<sup>9</sup> “Religiöse Begleitung im interkulturellen Kontext”. Më tepër shih nën linkun:  
<http://www.linguistik.zhaw.ch/de/linguistik/lcc/weiterbildungsangebote/zertifikatslehrgaenge-casdasmas/cas-religioese-begleitung-im-interkulturellen-kontext.html>

<sup>10</sup> Më gjerësisht shih, NFP 58 Themenheft I (2010), *Imam-Ausbildung, islamische Religionspädagogik und andere Aspekte des Islams in der Schweizer Öffentlichkeit*, f. 20. Si dhe nën linkun (Shikuar më 11 tetor 2011):  
[www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58\\_Themenheft01\\_DE\\_def.pdf](http://www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58_Themenheft01_DE_def.pdf)

## Literatura:

- Alimi, Bekim & Zuzo, Zijad (2011), *Islamischer Religionsunterricht an Schweizer Schulen*, CAS Religiöse Begleitung im interkulturellen Kontext, ZHAW für Angewandte Wissenschaft und Islamische Gemeinschaft Will. Si edhe nën linkun: [www.uais.ch/new1/images/files/Islamischer\\_Unterricht\\_in\\_Wil.pdf](http://www.uais.ch/new1/images/files/Islamischer_Unterricht_in_Wil.pdf)
- Certificat de formation continue universitaire: *Islam, Musulmans et Société civile*. Nën linkun: <http://unifr.ch/webnews/content/20/File/certificatIslam.pdf>
- Der Schweizerische Bundesrat, *Verordnung über die Integration von Ausländerinnen und Ausländern (VIntA)*, 24 tetor 2007. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: [www.admin.ch/ch/d/sr/1/142.205.de.pdf](http://www.admin.ch/ch/d/sr/1/142.205.de.pdf)
- Ettinger, Patrik & Imhof, Kurt (2009), *Ethnisierung des Politischen und Problematisierung religiöser Differenz (Schlussbericht)*, NFP 58 „Religionsgemeinschaften, Staat und Gesellschaft“. Shiko edhe nën linkun: [www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58\\_Schlussbericht\\_Imhof.pdf](http://www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58_Schlussbericht_Imhof.pdf)
- Mäder, Lukas: „Wer ist für eine Imam-Ausbildung zuständig?“, e përditshmja zvicerane „20 Minuten“. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: [www.20min.ch/news/schweiz/story/16402185](http://www.20min.ch/news/schweiz/story/16402185).
- NFP 58 Themenheft I (2010), *Imam-Ausbildung, islamische Religionspädagogik und andere Aspekte des Islams in der Schweizer Öffentlichkeit*, f. 20; Po edhe nën linkun: [www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58\\_Themenheft01\\_DE\\_def.pdf](http://www.nfp58.ch/files/downloads/NFP58_Themenheft01_DE_def.pdf)
- Religiöse Begleitung im interkulturellen Kontext. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: <http://www.linguistik.zhaw.ch/de/linguistik/lcc/weiterbildungsangebote/zertifikatslehrgaenge-cas-dasmas/cas-religioese-begleitung-im-interkulturellen-kontext.html>
- Rudolph, Ulrich dhe të tjerë (2009): *Imam-Ausbildung und islamische Religionspädagogik in der Schweiz? (Schlussbericht)*, Bern, NFP 58 „Religionsgemeinschaften, Staat und Gesellschaft“ po ashtu edhe nën linkun: [www.nfp58.ch/files/downloads/Schlussbericht\\_Rudolph\\_de.pdf](http://www.nfp58.ch/files/downloads/Schlussbericht_Rudolph_de.pdf)
- Web faqja zyrtare e Parlamentit Federal të Zvicrës, „Ausbildung von Imamen in der Schweiz. Wie geht es weiter? (Interpellation)“. Shikuar më 11 tetor 2011 nën: [www.parlament.ch/D/Suche/Seiten/geschaefte.aspx?gesch\\_id=20093743](http://www.parlament.ch/D/Suche/Seiten/geschaefte.aspx?gesch_id=20093743)